

## **BANKA E SHQIPERISE DHE UNIVERSITETI I KORÇES**

# *“Banka Qendrore dhe Sistemi Bankar në Shqipëri”*

**Leksion i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë  
prof.dr.Shkëlqim CANI në Fakultetin Ekonomik  
të Universitetit të Korçës**

**Korçë, më 02 Prill 2004**

# **BANKA QENDRORE DHE SISTEMI BANKAR NE SHQIPËRI**

## **HYRJE**

Sistemi financiar thuhet dhe pranohet se është lubrifikanti i ekonomisë së tregut. Për të kuptuar këtë thënie duhet të kemi të qartë rolin e sistemit financiar në një ekonomi tregu. Ky sistem siguron mjetet e pagesës në ekonomi dhe ndikon aktivitetin real të saj, nëpërmjet realizimit të ndërmjetësimit financiar dhe transmetimit të politikës monetare.

Por, në vendet në zhvillim, një ndër të cilët është dhe Shqipëria, sistemi bankar shpesh është i njëvlerëshëm me sistemin financiar. Për këtë arsye, ky leksion do të përqendrohet në ndërtimin dhe funksionimin e këtij sistemi në Shqipëri, duke menduar se konkluzionet e nxjerra vlejné për të gjithë sistemin financiar.


Për të plotësuar prezantimin e sistemit bankar, në vijim do të jepet një historik i shkurtër i zhvillimit të tij në Shqipëri dhe një vlerësim i shkurtër i gjendjes aktuale të tij.

## I. NDËRMJETËSIMI FINANCIAR.

### AKTIVITETI EKONOMIK DHE NDËRMJETËSIMI FINANCIAR

Aktiviteti ekonomik përmbledh dy flukse të mëdha: fluksin real dhe fluksin monetar. Fluksi real (linjat e jashtme të diagramës) përbëhet nga lëvizja e mallrave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit: punës, tokës dhe kapitalit. Fluksi monetar (linjat e brendshme të diagramës) është kundërpastia e tyre, cmimi ose vlera monetare e mallrave e shërbimeve dhe shpërblimi i faktorëve të prodhimit, punës, tokës dhe kapitalit. Diagrama e mëposhtme ilustron rrjedhën e aktivitet ekonomik.

Diagrama e rrjedhës së aktivitetit ekonomik.



**Familjet dhe shoqëritë tregtare<sup>1</sup> përbëjnë agjentët kryesorë ekonomikë.** Këta agjentë ndërveprojnë në tregun e faktorëve të prodhimit dhe në tregun e produkteve, mallra e shërbime. Familjet janë ofrueset kryesore të faktorëve të prodhimit dhe konsumatorët e produkteve përfundimtarë. Në të kundërt, shoqëritë janë kërkuesit e faktorëve të prodhimit dhe ofruesit e produkteve.

**Sistemi financiar ka një rol të pazëvendësueshëm në aktivitetin ekonomik.** Ky sistem kryen dy funksione kryesore:

<sup>1</sup> Këtu përfshihen kompanitë publike dhe private (firma ose sipërmarje të tjera).

- **Ai bën të mundur krijimin e mjeteve të pagesës në ekonomi.** C’do lëvizje reale në ekonomi: puna toka, mallrat dhe shërbimet, kanë një kundërparti monetare. Në mungesë të kësaj kundërpattie, shkëmbimi do të bëhej mall me mall. Por, ju duhet të gjeni dikë që të jetë i gatshëm të kryejë shkëmbimin pra, në një farë mënyre, të ketë nevoja të kundërta me ju<sup>2</sup>. Shkëmbimi i mallrave kundrejt një kundërpattie monetare, e cila mund të këmbëhet më tej lirisht me c’farëdolloj malli, lehtëson mjaft shkëmbimet. Këto lloj shkëmbimesh janë tipar dallues i çdo shoqërie të zhvilluar.
- **Sistemi financiar realizon procesin e ndërmjetësimit financiar:** kanalizimin e kursimeve (zakonisht të familjeve) në kredi dhe investime (zakonisht firmat).

### **Sistemi financiar i një vendi është i përbërë nga (i) tregjet financiare dhe (ii) ndërmjetësit financiarë.**

**Tregjet financiare** historikisht kanë qenë vendet ku realizohej shkëmbimi i aktiveve financiare<sup>3</sup>. Kohët e fundit, lindja e teknologjive të reja të informacionit ka bërë që tregu financiar të marrë më tepër kuptimin e një tërësie sistemesh dhe procedurash që mundësojnë shkëmbimin e aktiveve financiare, sesa të një hapësire gjeografike. **Ndërmjetësit financiarë**, ose institucionet financiare, kryejnë funksionin e ndërmjetësimit nëpërmjet grumbullimit të fondeve të individëve që dëshirojnë të investojnë kursimet e tyre dhe i vënë këto fonde në dispozicion të kompanive apo të firmave që kërkojnë financim. Ndërmjetësit financiarë janë pjesëmarrës në tregun financiar.

Për të patur më të qartë rolin e ndërmjetësit financiar, le të ndalemi në vijim në funksionet kryesore të ndërmjetësve financiarë.

### **FUNKSIONET E NDËRMJETËSVE FINANCIARË.**

Në ditët e sotme, pavarësisht se tregjet financiare janë sofistikuar dhe individët mund të investojnë kursimet e tyre drejtpërdrejt në firmat huamarrëse, institucionet financiare vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në ndërmjetësimin e fondeve. Niveli i ndërmjetësimit financiar ndikon drejtpërsëdrejti në nxitjen e investimeve dhe në rritjen

<sup>2</sup> P.sh., n.q.s. ju dëshironi të shkëmbeni një televizor kundrejt një sasi mollësh, duhet të jeni dikë që të dëshirojë të bëjë shkëmbimin e kudërt, një sasi mollësh kundrejt një televizori. Në këtë mënyrë, n.q.s. në ekonomi do të kishim  $n$  mallra, atëherë do në ekonomi do të kishim  $\frac{n * (n - 1)}{2}$  cmime.

<sup>3</sup> Aktiv i financiar, ose letra me vlerë, është një kontratë e cila sanksionon detyrimin e huamarrësit për të paguar borxhin sipas kushteve të përcaktuara. Aktive financiare janë paraja fizike, depozitat bankare, bonot e thesarit, aksionet, obligacionet, etj..

ekonomike. Ndërmjetësit financiarë veprojnë si agjentë për kursimtarët duke iu siguruar informacionin cilësor të nevojshëm për investimin e kursimeve të tyre.

1. **Ndërmjetësit financiarë rritin eficiencën e investimit të kursimeve në ekonomi.** Ata arrijnë të sigurojnë ekonomi të shkallës<sup>4</sup>, duke reduktuar ndjeshëm koston e informacionit dhe të transaksioneve.
2. **Ndërmjetësit financiarë sigurojnë transformimin e natyrës së aseteve.** Ata emetojnë detyrime financiare të cilat iu përshtaten preferencave të individëve që investojnë kursimet e tyre, pasi kanë kosto më të ulët monitorimi, likuiditet më të lartë, si dhe janë më pak të ekspozuara ndaj ndryshimeve të çmimit. Një kursimtar ka më tepër besim duke depozituar paratë në bankë sesa duke ia huajtur ato direkt një firme.
3. **Ndërmjetësit financiarë reduktojnë rrezikun nëpërmjet diversifikimit të portofolit.** Ata marrin përsipër rrezikun e përshtatjes së maturiteteve midis aseteve dhe detyrimeve duke ju përshtatur më mirë preferencave të njëjësive suficitare dhe deficitare të ekonomisë.
4. **Institucionet financiare luajnë një rol kyç në transmetimin e politikës monetare,** meqenëse detyrimet e institucioneve depozituese janë një komponent i rëndësishëm i ofertës së parasë, e cila ka ndikim në normën e inflacionit.
5. Shpeshherë bankat **mund të jenë e vetmja mundësi financimi për sektorë të veçantë strategjikë të ekonomisë,** duke shërbyer në shpërndarjen sa më eficiente të fondeve të grumbulluara.
6. **Së fundi, institucionet financiare luajnë një rol të veçantë në rritjen e eficiencës së shërbimit të pagesave,** e cila ndikon në zhvillimin ekonomik.

Ekzistojnë një numër i madh institucioneve financiare që kryejnë këto funksione e që kanë përparësitë e mësipërme, por për nga karakteristikat që ato kanë klasifikohen në: institucione financiare bankare, institucione financiare jobankare dhe institucione financiare të investimeve. Megjithatë, në këtë material, me ndërmjetësues financiar, do të kuptohet institucionet financiare bankare, sepse sistemi bankar është segmenti më i zhvilluar i sektorit financiar në Shqipëri.

---

<sup>4</sup> Ekonomia e shkallës i referohet uljes së koston mesatare të një transaksioni si pasojë e rritjes së vëllimit të tyre. Duke qenë se një pjesë e kostove të transaksioneve është fikse (grumbullimi i informacionit, analiza dhe përpunimi, komisioni, etj.), sa më e madhe të jetë vlera e transaksionit, aq më e vogël është kostoja mesatare e tij.

## II. NDËRTIMI DHE FUNKSIONIMI I SISTEMIT BANKAR.

Sistemi bankar, në ekonomitë e organizuara dhe që funksionojnë sipas parimeve të tregut të lirë, është i ndarë në dy nivele. Ndarja e sistemit bankar në nivele bëhet për të identifikuar funksionet e ndryshme që kryejnë bankat e nivelit të dytë dhe banka qendrore. Përfshirja e bankës qendrore në nivelin e parë apo e bankave tregtare në nivelin e dytë nuk tregon aspak rëndësinë relative të këtyre institucioneve.

**Në nivelin e parë është banka qendrore.** Banka qendrore është një institucion kushtetues i cili, në një këndvështrim të gjerë, ushtron funksione "qeverisëse"<sup>5</sup>. **Banka e Shqipërisë është banka qendrore e Republikës së Shqipërisë.**

**Në nivelin e dytë qëndrojnë bankat tregtare.** Këto banka janë ndërmjetës të pastër financiarë, të ngritura në formën e shoqërive aksionere dhe që kanë si qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre.

### FUNKSIONET E BANKËS SË SHQIPËRISË

**Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur.** Misioni i Bankës së Shqipërisë është i thjeshtë: të "luftojë" inflacionin në ekonomi. Sipas ligjit Nr.8269, dt. 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", "*objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e cmimeve*". Në praktikë, ky objektivi i Bankës së Shqipërisë reduktohet në *mbajtjen e inflacionit në shifra pozitive, por në nivele të ulta. Inflacioni pozitiv në nivele të ulta, në pjesën më të madhë të vendëve të zhvilluara, përkthehet në ruajtjen e inflacionit rreth nivelit 2 për qind. Në Shqipëri, Banka e Shqipërisë e kupton inflacionin pozitiv në nivele të ulta si një objektivi inflacioni në intervalin 2-4 për qind.*

Ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në ekonomi bëhet gjithnjë në funksion të përmbushjes së këtij objektivi. Politika monetare ka si instrument kryesor normat e interesit. Banka qendrore lëviz nivelin e normave të interesit për të sjellë inflacionin brenda objektivit të saj.

---

<sup>5</sup> Një aspekt i rëndësishëm i punës së bankës qendrore është nxjerrja e akteve ligjore e nënligjore në funksion të rregullimit të funksionimit të sistemit bankar, si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre. Po kështu, banka qendrore është institucioni i vetëm të cilit shteti i lejon të drejtën e shtypjes dhe emetimit të kartmonedhave.

Kështu, në vija të përgjithshme, mund të themi se:

- **Ulja e normave të interesit** (i ashtuquajtur "lehtësim" i politikës monetare) tregon se niveli i inflacionit nuk përbën shqetësim për Bankën e Shqipërisë, ose se inflacioni i parashikuar është nën objektivin e saj;
- **Rritja e normës së interesit** tregon se në ekonomi ekzistojnë presione inflacioniste të cilat mund të bëjnë që inflacioni faktik të jetë më i lartë se objektivi i Bankës së Shqipërisë. Rritja e normës së interesit (i ashtuquajtur "shtrëngim" i politikës monetare) duhet ta korrektojë këtë problem.

Banka e Shqipërisë ka dhe objektiva të tjerë. Duke iu referuar përsëri ligjit "Për Bankën e Shqipërisë" shohim se:

*"Në përputhje me objektivin e saj kryesor dhe mbi bazën e tregut të brendshëm bankar, (Banka e Shqipërisë) nxit dhe mbështet zhvillimin e regjimit dhe të sistemit të këmbimeve valutore, tregun e brendshëm financiar, sistemin e pagesave, si dhe ndihmon në përmirësimin e kushteve monetare e kredituese, në mbështetje të stabilitetit dhe të zhvillimeve ekonomike të vendit.*

*Objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë, të kushtëzuara nga objektivi kryesor i saj, duhet të nxisin ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar të bazuar në parimet e tregut".*

Ligji është i qartë në përcaktimin e prioriteteve të objektivave: **objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është kontrolli i nivelit të inflacionit. Të gjithë objektivat e tjerë, të përmendur më sipër, janë të kushtëzuar nga respektimi i objektivit kryesor.**

**Në funksion të realizimit të objektivave të saj, Banka e Shqipërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ka për detyrë:**

- hartimin dhe zbatimin e politikës monetare të vendit;
- hartimin dhe zbatimin e politikës valutore të vendit;
- hartimin e rregullave për lëvizjen e fondeve valutore, si brenda vendit ashtu dhe jashtë kufijve të tij;
- licencimin e bankave dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, me qëllim sigurimin e stabilitetit të sistemit bankar;
- emetimin e monedhës dhe kartëmonedhës;
- këshillimin e qeverisë dhe sigurimin e një niveli të kualifikuar ekspertize në hartimin dhe zbatimin e të gjitha politikave të tjera ekonomike dhe financiare të vendit."

**Box 1. Politikat për stabilitetin financiar**

Politikat për stabilitetin financiar ndahen në tre grupe të mëdha.

**Politikat parandaluese** janë masa paraprake të cilat synojnë reduktimin e kostove potenciale të destabilizimit financiar. Disa nga këto politika përfshijnë krijimin e infrastrukturës ligjore të shëndetshme për zbatim nga ana e institucioneve financiare, të rregullimeve bankare për drejtimin e bankave dhe institucioneve të tjera financiare, të masave të sigurta për kryerjen e pagesave dhe të kleringut, të skemave të sigurimit të depozitave etj..

**Politikat administruese** janë masa të cilat synojnë kapërcimin e paqëndrueshmërive financiare ose zbutjes së ashpërsisë së tyre kur ato ndodhin. Këtu përfshihet një nga lehtësitë e ofruara nga banka qendrore: funksioni i saj si huadhënës i fundit në radhë, lehtësi e cila mbron institucionet financiare të shëndetshme nga mungesat e likuiditetit. Marrja në kohë e masave të duhura ndaj dobësisë të institucioneve financiare, kufizon kostot që rrjedhin si rezultat i paqëndrueshmërisë.

**Politikat rehabilituese** përdoren për minimizimin e kostove që rrjedhin pas një destabilizimi financiar. Ato përfshijnë ristrukturimin e institucioneve të dëmtuara financiarisht nëpërmjet masave të ndryshme të tilla si rikapitalizimi, bashkimi me institucione të shëndetshme, ndërrimi i ekipit drejtues të institucionit etj.. Këto masa janë të orientuara drejt reduktimit të kostove të paqëndrueshmërisë financiare të cilat rrjedhin nga dëmtimi i një pjese të sistemit financiar.

**FUNKSIONET E BANKAVE TË NIVELIT TË DYTË****Banka është shembulli më tipik i një ndërmjetësi financiar.**

Historikisht, roli i tyre ka qenë grumbullimi i kursimeve të ekonomisë në formën e depozitave dhe vënia e këtyre kursimeve në dispozicion të sektorëve të ekonomisë që kanë nevojë, në formën e kredive<sup>6</sup>. Por, zhvillimi i shpejtë i sistemit financiar, i shoqëruar me rritjen e konkurrencës midis ndërmjetësve financiarë, ka bërë që bankat të zgjerojnë ndjeshëm gamën e veprimtarisë së tyre. Kështu, praktika botërore po tregon rivijëzimin e dy profileve të ndryshme të institucioneve bankare<sup>7</sup>:

<sup>6</sup> Ligji Nr. 8365, dt. 2. 7. 1995, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 2 përcakton se bankë do të quhet ai biznes i cili merret me grumbullimin e depozitave dhe dhënien e kredive, për llogari dhe në ngarkim të tij.

<sup>7</sup> Aktualisht, ka institucione bankare që kryejnë të dyja këto funksione dhe, për këtë arsye, ato njihen edhe si banka universale.



- **Bankat “me pakicë”** – të cilat vazhdojnë të kryejnë përgjithësisht aktivitetet tradicionale, pra grumbullimin e depozitave dhe dhënien e kredive. Fokusi i këtyre bankave janë klientët e vegjël dhe të mesëm, dhe;
- **Bankat investuese** – të cilat janë specializuar në mbështetjen e biznesit të madh dhe korporatave, duke përfshirë këshillimin financiar, administrimin e fondeve të korporatave dhe mbështetjen me financim të tyre.

Me fjalën bankë, në këtë leksion, do të kuptojmë bankat “me pakicë”; së pari, sepse këto janë tipi më përfaqësues i bankave dhe, së dyti, sepse të gjitha bankat në Shqipëri kanë këtë natyrë. **Bankat tregtare nuk duhen ngatërruar me fondet e zhvillimit. Qëllimi i ekzitencës së tyre është prodhimi i fitimit.** Ato nuk mund të kryejnë shërbime sociale apo të sigurojnë financime për projekte jorentabël. Rrjedhimisht, bankat duhet të jenë të pavarura nga faktorë të tjerë (aq më tepër nga politika) në vendimet e tyre për shpërndarjen e fondeve.

Në vijim, do paraqesim shkurtimisht funksionet kryesore të industrisë bankare:

- **Banka është një ndërmjetës financiar.** Ajo grumbullon depozita nga një numër i madh personash dhe i jep këto depozita hua. Në këtë këndvështrim, esenca e biznesit bankar është përpunimi i informacionit për të lehtësuar këtë fluks monetar dhe për të rezultuar fitimprurëse.
- **Bankat realizojnë një vëllim të madh pagesash në ekonomi,** për llogari të firmave apo individëve. Në mungesë të bankave, pjesa më e madhe e pagesave do të bëhej me *cash*, me gjithë mangësitë e theksuara që shfaq një sistem i tillë.
- **Bankat tregtare janë esenciale për transmetimin e politikës monetare në ekonomi.** Këto banka janë hallka e parë e zinxhirit të mekanizmit të transmetimit. Mungesa e tyre do ta bënte të pamundur ndikimin e autoriteteve në ekonomi; kjo e fundit do të zhvillohej me luhatje, duke ulur ritmin e zhvillimit.

### **Box 2. Trendet e fundit të zhvillimit të bankave.**

Industria bankare në botë është duke pësuar ndryshime të shpejta strukturore. Këto ndryshime vihen re jo vetëm në vendet e zhvilluara, por edhe në ato në zhvillim. Monitorimi dhe vlerësimi i këtyre prirjeve është shumë i rëndësishëm dhe çdo politikë e hartuar në mbështetje të kreditimit të sektorit privat duhet t`i mbajë parasysh ato.

1. **Teknologjia e informacionit.** Aplikimi i teknologjive më të fundit informatike do të jetë forca kryesore e zhvillimit të industrisë bankare në të ardhmen. Informatizimi i procesimit të informacionit do të ulë koston e transaksioneve dhe, nëpërmjet

bankingut elektronik (e-banking), do të ndryshojë mënyrën e komunikimit të klientëve me bankat.

2. **Derregullimi.** Tradicionalisht, industria bankare ka qenë një biznes shumë i mbrojtur dhe i rregulluar me ligj. Së fundi, derregullimi (tendenca e reduktimit dhe e thjeshtimit të ligjeve) ka ndryshuar fytyrën e industrisë bankare në të gjithë botën. Në vend të kontrollit të normave të interesit të depozitave apo kufijve të kredisë, fokusi i rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare tani ka kaluar në përcaktimin e procedurave dhe sistemeve të përshtatshe për eliminimin e rrezikut. Në të shkuarën, segmenti bankar gëzonte një situatë pothuajse monopoliste brenda sektorit të ndërmjetësve financiarë. Sot, po vihet re një rritje e konkurrencës jo vetëm në sektorin bankar por edhe në atë financiar. Rrjedhojë e kësaj është marrja e një rreziku më të madh nga bankat.
3. **Konsolidimi.** Derregullimi i sektorit ka sjellë një konsolidim të shpejtë të sektorit dhe një rritje të bashkimeve të bankave. Këto bashkime justifikohen me ekonominë e shkallës dhe uljet e kostove që ato sigurojnë. Kjo nuk do të thotë se një bankë e vogël nuk mund të jetë efiçente, por numri i bankave të tilla do të vijë në rënie në të ardhmen.
4. **Privatizimi dhe pronësia e huaj.** Privatizimi, kryesisht në pronarë të huaj, është një tjetër trend i qartë në industrinë bankare. Bankat shtetërore dhe ato "kombëtare" janë duke humbur terren, si pasojë e globalizimit. Ky proces kërkon një vizion më të gjerë dhe një strategji ndërkombëtare për të mbijetuar në këtë sektor.
5. **Ndryshimi i sjelljes së bankave.** Një tendencë e vërejtur së fundmi, është fakti se firmat po i drejtohen gjithnjë e më shumë tregut financiar për financim (kryesisht bursave), duke anashkaluar bankat. Gjithsesi, mundësinë reale për t'iu drejtuar direkt tregut financiar e kanë një numër firmash, kryesisht të mëdha. Bizneset e vogla dhe të mesme do të vazhdojnë të mbështeten në bankat për të siguruar financime.

Funksionet që përmbushin bankat tregtare ilustronë qartë rolin e tyre në një ekonomi tregu, si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluara. Për këtë arsye, stabilitetit të sistemit bankar i kushtohet një rëndësi e madhe, si në literaturë ashtu edhe në praktikë. **Bankat e zhvillojnë biznesin e tyre me paratë e personave të tjerë.** Kjo i bën ato të vecanta në krahasim me bizneset e tjera. Falimentimi i një banke, në ndryshim me rastin e bizneseve të tjera, prek një numër shumë të madh personash. Pasojat ekonomike dhe sociale ndihen në një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë. Sistemi bankar është mjaft i ekspozuar ndaj rreziqeve, sidomos ndaj turbullirave politike apo sociale. **Rrënja e fjalës kredi vjen nga latinishtja: *credo dmth besoj.*** Me fjalë të tjera, banka që huan para beson se ato do të kthehen, normalisht të tëra, në kohë dhe duke përfshirë dhe interesin.

**Eksperiencia botërore ka treguar se krizat bankare janë mjaft të kushtueshme.** Normalisht, ato kushtojnë nga 2% në 10% të PBB-së, por janë vërejtur raste kur fatura e tyre financiare ka arritur edhe në 50% të PBB-së (Frydl, 1999).

Sistemi bankar është bërthama e sistemit financiar në ekonominë në tranzicion. Prandaj, rregullimi dhe funksionimi i saktë i tij janë çështje me rëndësi mjaft të madhe në stabilitetin e sistemit financiar. Ky rol i është besuar bankës qendrore. Banka qendrore është garante për stabilitetin e sistemit bankar. Në vija të përgjithshme, banka qendrore e ushtron këtë përgjegjësi në tre hapa:

- (i) **licencimi** i bankave sipas rregullave të përcaktuara qartë;
- (ii) **hartimi i bazës ligjore dhe nënligjore** që rregullon veprimtarinë e sistemit bankar; dhe,
- (iii) **mbikëqyrja** e vazhdueshme e punës së bankave dhe e gjendjes financiare të tyre.

### Box 3. Veçori specifike të bankave në ekonominë në tranzicion.

Studimi i prirjeve të sistemit bankar në vendet e zhvilluara përbën një avantazh të madh për vendet në tranzicion. Në një farë mënyre, vendet në tranzicion e shikojnë në pasqyrë të ardhmen. Por, ato duhet ta shfrytëzojnë këtë njohuri, dhe kjo përmban disa vështirësi dhe sfida. Ky proces ka anë pozitive dhe negative<sup>8</sup>.

#### 1. Anët pozitive:

- **Bankat në vendet në tranzicion ndjekin trendet botërore.** Disa trende janë më të ngadalta (IT) dhe disa më të shpejta (privatizimi dhe pronësia e huaj), por nuk ka dyshim se trendet e përmendura më sipër janë të pranishme edhe në vendet në tranzicion.

#### 2. Anët negative:

- **Shumica e vendeve në tranzicion nuk iu shmangen krizave bankare.** Është e debatueshme nëse Shqipëria ka patur apo jo një krizë të sistemit bankar. Debati do të përqendrohej në faktin se çfare shkalle duhet të arrijë një çrregullim në sistemin bankar që të mund të quhet krizë. Në këtë këndvështrim, mund të themi se Shqipëria nuk ka patur kriza të mirëfillta bankare, por elemente ose premisa të krizave janë shfaqur (në vitet 1996-1997 si pasojë e fenomenit *piramida* dhe në vitin 2002 si pasojë e tërheqjes së depozitave).
- **E kaluara socialise dhe trashëgimia e saj janë të vështira për t`u zhdukur.** Në socializëm, kredia bankare nuk konsiderohej si aspekt i një biznesi normal. Roli i bankave ishte për "të ndihmuar" ekonominë me hua me norma interesi të ulët, nën normën e interesit që do të rezultonte në një treg të lirë. Për të ndryshuar këtë mentalitet duhet të sigurohet një mbështetje e gjërë politike për reforma. Në analizë të fundit, politikat ekonomike të drejta janë në favor të zhvillimit të vendit. Por, këto politika duan kohë që të japin ndikime reale, ndërkohë që në periudhën afatshkurtër ato shoqërohen me kosto. Ky problem, i shton një dimension politik këtij diskutimi, që nuk duhet nënvlerësuar.

<sup>8</sup> Për më gjerë shiko Blejer and Skreb (1999)

### III. ZHVILLIMI I SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR<sup>9</sup>.

Ecuria e sistemit bankar mund të ndahet në tre periudha: periudha 1946-1990; periudha 1991-1996 dhe periudha 1997-2003. Periudhat e zhvillimit të sistemit bankar reflektojnë gjerësisht marrëdhëniet ekonomike, sociale dhe politike mbizotëruese në Shqipëri.

#### ZHVILIMET NË SISTEMIN BANKAR '46 – '90.

Sistemi bankar gjatë socializmit ishte një sistem i centralizuar plotësisht. Deri në vitin 1976 ai përbëhej nga një bankë e vetme, **Banka e Shtetit Shqiptar**, që shërbente në të njëjtën kohë si autoritet monetar dhe si kredituese e ekonomisë. Ndërkohë roli i saj si ndërmjetës financiar ishte mjaft i kufizuar, pasi shpërndarja e kredisë drejtohej sipas një plani të centralizuar. Banka shërbente thjesht si institucion rregjistruar i transaksioneve midis ndërmarrjeve prodhuese.

Përveç Bankës së Shtetit Shqiptar funksiononte edhe **Drejtoria e Përgjithshme e Arkave të Kursimit dhe të Sigurimeve** që kryente grumbullimin e kursimeve të popullsisë si dhe merrej me sigurimin e pasurisë, kryesisht të asaj kooperativiste<sup>7</sup>. Në vitin 1977 u krijua **Banka Bujqësore**, si një bankë e veçantë nëpërmjet shkëputjes së një seksioni të Bankës së Shtetit Shqiptar. Kjo bankë mbulonte ofertën për fonde të sektorit bujqësor. Në vitin 1990, Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë të Bankës së Shtetit Shqiptar shërbeu si bazë për themelimin e **Bankës Tregtare Shqiptare** e cila kryente funksionin e financimit dhe të nxitjes së eksporteve dhe të pagesave me jashtë.

Tranzicioni e gjeti Shqipërinë si vendin më të varfër të Europës, si një vend komunist me tipare të ngjashme me vendet tjera socialiste dhe veçanërisht me ato të Evropës Juglindore por edhe me veçori të theksuara që e dallojnë atë nga vendet e tjera ishkomuniste<sup>10</sup>. Shqipëria hyri në

<sup>9</sup> Kjo pjesë është mbështetur gjerësisht në referatin "Sistemi financiar shqiptar në tranzicion: progres apo brishtësi", mbajtur nga Sh. Cani dhe S. Haderi në konferencën e tretë kombëtare të Bankës së Shqipërisë, "Banka e Shqipërisë në dekadën e dytë të tranzicionit".

<sup>10</sup> Modeli shqiptar u karakterizua nga eliminimi i të gjitha formave të pronës private nëpërmjet shtetëzimit të plotë të industrisë dhe kolektivizimit të bujqësisë; nga mbështetja e plotë në planifikimin dhe drejtimin e centralizuar; nga zbatimi ekstrem i parimit të mbështetjes në forcat e veta; nga një mungesë pothuajse e plotë e traditës demokratike dhe nga zbatimi ekstrem i parimit të luftës së klasave. Për një trajtim më të hollësishm shih IMF (1992), Pashko (1994), Muço 1997, Haderi et al.(1999), Kule, Haderi, 2001.

tranzicion si vendi më pak i përgatitur nga pikëpamja ekonomike, politike, sociale dhe kulturore për të realizuar reforma rrënjësore drejt ekonomisë së tregut (Kule, Hadëri 2001).

**Box 4. Probleme të sistemit bankar në ekonominë e centralizuar.**

Në mënyrë të përmbledhur, sistemi bankar socialist në pragun e tranzicionit karakterizohej nga mangësi serioze për një sistem bankar të ekonomisë së tregut të lirë si:

- roli i tij si ndërmjetës financiar ishte mjaft i kufizuar;
- mungonte vlerësimi i kredisë dhe për rrjedhojë edhe menaxhimi i riskut;
- kursi i këmbimit llogaritej por jo risku i tij;
- sistemi i kontabilitetit ndryshonte rrënjësisht nga praktikat ndërkombëtare të kontabilitetit, ndryshim që shfaqej në mënyrë të veçantë në sektorin bankar;
- mungesa e përvojës bankare për aktivitetet e një ekonomie tregu përbën një faktor tjetër negativ dhe drejtuesit e bankave nuk kishin përvojë ndërkombëtare.

**ZHVILIMET NË SISTEMIN BANKAR '91 – '96.**

Si pjesë e reformës ekonomike të filluar në vitin 1992, reforma e sistemit bankar filloi si reformë institucionale me ndryshimin e dispozitave ligjore. Kuvendi, në prill të vitit 1992, miratoi ligjin "Për Bankën e Shqipërisë", si dhe ligjin "Për sistemin bankar në Republikën e Shqipërisë". Këto ligje shënuan kalimin e sistemit bankar nga një nivelor në një sistem bankar prej dy nivelesh. Mbi bazën e këtyre ligjeve iu hap rruga procesit të licencimit të bankave të reja private dhe rregullimit të sistemit bankar nga banka qendrore.

**Banka e Shqipërisë** u krijua si banka qendrore e vendit, ndërkohë që tri banka të tjera shtetërore: **Banka e Kursimeve**, **Banka Kombëtare Tregtare** dhe **Banka Tregtare Agrare**, përbënin nivelin e dytë të sistemit bankar. Banka e Kursimeve ishte pasardhëse e Institutit të Kursimit. Banka Kombëtare Tregtare ishte një shkrirje e aktivitetit tregtar të brendshëm të Bankës së Shtetit Shqiptar me Bankën Tregtare Shqiptare.

Gjithashtu, në vitin 1992 u licencuan dy banka me kapital të përbashkët (të huaj dhe të Qeverisë Shqiptare): **Banka Italo-Shqiptare** dhe **Banka Arabo-Shqiptare Islamike**. Në vitin 1993 u krijua **Banka Dardania** nga Qeveria e Kosovës dhe në vitin 1996 u licencuan dy banka me kapital grek: **Banka e Tiranës** dhe **Dega e Bankës Kombëtare të Greqisë**.

Karakteristikë e zhvillimit të sektorit bankar në këto vite është dominimi i bankave me kapital shtetëror.

Megjithëse me ritme të ngadalta, vihet re prirja e rritjes së aktivitetit bankar. Në vitin 1995, në vend operonin 6 banka me një total aktive prej 80.8 miliardë lekësh, që përbënin 35% të PBB-së të atij viti. Në vitin 1996 totali i aktiveve të sistemit bankar arrin në 128.8 miliardë lekë ose 46% të PBB-së. Rritja e aktiveve të sistemit bankar prej 48 miliardë lekësh i përket kryesisht Bankës Kombëtare Tregtare, si rezultat i rritjes së llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat nga firmat piramidale<sup>11</sup>.

Gjatë kësaj periudhe u bënë një sërë përpjekjesh për ristrukturimin dhe përgatitjen e bazës ligjore për privatizimin e bankave, përpjekje të cilat përgjithësisht nuk rezultuan efektive.

#### **Box 5. Probleme të sistemit bankar në vitet e para të tranzicionit.**

Krahas zhvillimeve pozitive, sektori bankar u shoqërua edhe me mangësi dhe zhvillime negative.

- **Niveli i ndërmjetësimit financiar ishte i kufizuar.** Bankat shtetërore që dominonin me rreth 90 % tregun e depozitave kryenin funksione të kufizuara të ndërmjetësimit financiar, ndërsa bankat e reja private ishin të kufizuara në numër, tepër të ngadalta dhe të painteresuara për tërheqjen e depozitave në lekë duke u përqendruar kryesisht në kreditimin e tregtisë. Niveli i kreditimit të ekonomisë ishte mjaft i ulët.
- **Huatë e këqija dhe të humbura u rritën** si pasojë e mungesës së një sistemi rregullues dhe mbikëqyrës të përshtatshëm. Vitet e para të tranzicionit u shoqëruan me një rënie të aktivitetit ekonomik për shkak të dobësive të ndërmarrjeve shtetërore, sidomos në degët e industrisë me teknologji të vjetër dhe me kërkesë në rënie, degë që përfaqësonin konsumatorë të rëndësishëm të bankave shtetërore. Kredia e pakthyer në afat u rrit nga 14% e stokut të kredisë në vitin '93 në rreth 60% në vitin 1997. (Cani 1995, Ibrahim i dhe Salko, 2001).
- **Sistemi i pagesave kishte dobësi të theksuara** dhe nuk i përgjigjej nevojave të ekonomisë. Kështu për shembull, në fundin e vitit 1996 realizimi i pagesave për transaksione nëpërmjet llogarive në degë të ndryshme të të njëjtës bankë kërkonte mesatarisht 5 – 6 ditë, ndërsa për transaksione ndërmjet bankave të ndryshme kërkonte mbi 15 ditë (Cani 1995, Jarvis 2001). Për këto arsye paraja jashtë bankave në duar të publikut ishte në nivele shumë të larta.
- **Kuadri ligjor në vitet e para të tranzicionit ishte i papërshtatshëm,** duke mos favorizuar zhvillimin e sistemit bankar.
- **Mungesa e përvojës bankare** për aktivitetet e një ekonomie tregu përbën një faktor tjetër negativ. Shumë nga drejtuesit e bankave nuk kishin përvojë ndërkombëtare dhe vinin nga sektorë të tjerë shtetërorë, madje edhe nga sektorë pa përvojë financiare.

<sup>11</sup> Firmat rentiere, si u quajtën në atë kohë, hapën llogari rrjedhëse dhe depozita pa afat pranë BKT-së në vitin 1996, për rreth 38 miliardë lekë.

### ZHVILIMET NË SISTEMIN BANKAR '97 – 03.

Stabiliteti makroekonomik ka njohur përmirësime gjatë kësaj periudhe, pas krizës së piramidave të viteve 1996-1997<sup>12</sup>. Reformat e sektorit financiar shënuan progres të rëndësishëm në këtë periudhë. Ato lidhen me privatizimin e bankave shtetërore dhe me hyrjet e bankave të reja private, të cilat kanë ndikuar në thellimin e ndërmjetësimit financiar dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve bankare.

Karakteristikë këtyre zhvillimeve ishte rritja e numrit të bankave nëpërmjet bankave të reja private, të cilat aktualisht kapin shifrën 16.

Në vitin 1997 u licencua një bankë tjetër me kapital tërësisht të huaj, **Banka Ndërkombëtare Tregtare**, ndërkohë që në vitin 1998 u licencua **Banka Amerikane e Shqipërisë** dhe **Dega e Tiranës e Bankës Alpha Credit**. Në vitin 1999 filluan aktivitetin edhe tre banka të tjera, **Banka e Parë e Investimeve**, **Banka Tregtare e Greqisë** dhe **Banka ProCredit (Fefad)**, ndërsa në vitin 2002 u licencua **Banka Shqiptare e Kreditit**. **Banka Credins** dhe **Banka Popullore** u licencuan në vitin 2003. Aktualisht, Shqipëria ka 5.3 banka për një milion banorë ndërkohë që Bullgaria ka thuajse të njëjtin tregues, Rumania ka 1.5 banka për një milion banorë, Hungaria 3 banka dhe Kroacia 10 banka<sup>13</sup>.

**Aktiviteti bankar ka ardhur duke u zgjeruar** bashkë me zgjerimin e bankave në treg, duke u rritur si aktivet ashtu edhe depozitat e bankave. Në fundin e vitit 2003, totali i aktiveve të sistemit rezultoi 373.6 miliardë lekë ose rreth 50% e PBB-së. Nga ana tjetër, niveli i depozitave ka shënuar rritje të vazhdueshme nga 178.2 miliardë lekë në vitin '98 në 323.2 miliardë në vitin 2003.

**Niveli i ndërmjetësimit financiar është thelluar më tej** duke pasqyruar prirjen pozitive të zhvillimeve në sektorin bankar. Raporti i depozitave totale ndaj PBB-së, që është një nga treguesit kryesorë të nivelit dhe thellësisë së ndërmjetësimit financiar, ka ardhur duke u rritur gjatë gjithë periudhës së tranzicionit dhe veçanërisht mbas vitit 1998, duke shënuar nivelin 43% në vitin 2003. Të njëjtën prirje shfaq edhe

---

<sup>12</sup> Mund të thuhet se dëmi më i madh ekonomik i krizës së piramidave ishte lëkundja e besimit të publikut në institucionet financiare.

<sup>13</sup> Të dhënat janë për vitin 2002.

raporti i depozitave me afat ndaj PPB-së, si treguesi më sinjifikativ i ndërmjetësimit, i cili është rritur ndjeshëm nga 12.8% në vitin 1994, në 29.3% në vitin 1998 dhe 35.3% në vitin 2003.

Një karakteristikë tjerër e zhvillimeve pozitive në sektorin bankar është **përmirësimi i tregut të kreditit**. Dy janë prirjet më pozitive që vihen re në këtë treg: e para rritja e vazhdueshme e kreditimit të sektorit privat dhe e dyta ulja e kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë.

**Përmirësimi i vazhdueshëm i infrastrukturës bankare**, ngritja dhe funksionimi i Agjensisë së Sigurimit të Depozitave në vitin 2002, përmirësimi i mbikëqyrjes bankare rritin besimin në sistemin bankar.

#### **Box 6. Sfidat aktuale të sistemit bankar.**

Me gjithë përmirësimet e vërejtura, sistemi bankar përballet edhe me disa sfida, të cilat kërkojnë zgjidhje gjatë periudhës në vazhdim.

- **Konkurrenca në sistemin bankar është në nivel relativisht të ulët.** Ajo shprehet në nivelin relativisht të ulët të shërbimeve të ofruara dhe në mungesën e mbulimit të plotë të territorit të vendit. Gjithsesi, gjatë dy viteve të fundit është vënë re tendenca e prezantimit të shërbimeve të reja bashkëkohore, si ATM etj..
- **Kreditimi i ekonomisë mbetet në nivele të ulta**, megjithë rritjen e tij gjatë viteve të fundit. Ai është mjaft poshtë atyre të vendeve të përparuara. Kështu, raporti i kredisë për sektorin privat ndaj PPB-së megjithëse është rritur, ishte vetëm 6.8% në vitin 2003. Megjithatë, privatizimi i Bankës së Kursimeve do të bëjë që bankat të jenë më agresive në kreditimin e ekonomisë.
- **Përqendrimi i kredisë në valutë.** Kredia e re e akorduar jepet kryesisht në valutë. Në fund të vitit 2003, rreth 75-80 për qind e kredisë së re të akorduar jepet në valutë.
- **Mungesa e një infrastrukture të plotë ligjore**, ose problemet me mos-zbatimin e ligjeve në fuqi, rritin rrezikun e kreditimit në ekonomi. Ngritja dhe funksionimi i Agjensisë së Informacionit të Kredive dhe zbatimi i procedurave ligjore të garancisë së kolateralit janë hapa të domosdoshëm në rritjen e kreditimit të ekonomisë.



## IV. GJENDJA AKTUALE E SISTEMIT BANKAR.

Tregu bankar pësoi zhvillime të rëndësishme gjatë vitit 2003. Zhvillimi më i spikatur, i cili do të ketë ndikime të mëdha në sistemin bankar, ishte privatizimi i Bankës së Kursimeve nga banka e njohur Raiffeisen. Gjatë këtij viti në tregun bankar hynë dy banka të reja, me kapital vendas.

Pas këtyre ndryshimeve sistemi bankar shqiptar numëron 16 banka gjithsej, detaje të cilave jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 1. Tregues për sistemin bankar.

Bankat	Nr. i degëve	Nr. i agjencive	Totali i depozitave / Totali i bilancit (%)	Totali i kredive / Totali i bilancit (%)	Bono thesari në % ndaj sistemit bankar
1. Banka Italo-Shqiptare		3	84.6	37.7	1.6
2. Banka e Kursimeve	14	83	94.9	0.3	76.1
3. Banka e Bashkuar e Shqipërisë	2		51.8	15.5	0.0
4. Banka Dardania			17.9	0.0	0.0
5. Banka Kombëtare Tregtare	15	1	91.8	8.5	10.4
6. Banka Tirana	12	2	86.3	27.1	4.7
7. Banka Ndërkombëtare Tregtare	1		63.0	44.7	0.2
8. Banka Amerikane e Shqipërisë	4		87.3	22.3	2.8
9. Banka Procredit	12		86.8	44.9	1.6
10. Banka Tregtare e Greqisë-Shqipëri			56.6	57.4	0.3
11. Banka Kombëtare Greke – dega Tiranë		4	86.6	22.6	0.8
12. Banka Alfa – dega Tiranë	7		54.7	47.2	1.6
13. Banka e Parë e Investimeve – dega Tiranë			16.1	1.2	0.0
14. Banka e Kreditit të Shqipërisë			37.9	0.0	0.0
15. Banka Credins		1	77.3	31.3	0.0
16. Banka Popullore <sup>14</sup>	1		--	--	--

Gjendja financiare e sistemit bankar gjatë viteve të fundit ka qenë e kënaqshme. Sistemi bankar shqiptar ka rezultuar në vazhdimësi me fitim, duke garantuar likuiditetin e tij dhe duke plotësuar gjithnjë e më shumë nevojat e ekonomisë për kredi.

<sup>14</sup> Banka Popullore, mori vetëm licencë paraprake në vitin 2003. Licencën për ushtrimin e aktivitetit ajo e ka marrë në vitin 2004 dhe ka filluar të ushtrojë aktivitetet bankar në muajin shkurt 2004.

Tabelë 2. Të ardhurat, shpenzimet dhe rezultati financiar (në miliardë lekë).

	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i të ardhurave	31.0	29.2	28.0	32.0
Totali i shpenzimeve	25.7	24.9	24.1	27.6
E ardhura neto (fitimi)	5.3	4.3	3.9	4.4

Gjendja e mirë e sistemit bankar gjen pasqyrim edhe në treguesit e rentabilitetit, të cilët kanë ardhur në rritje gjatë vitit 2003.

Tabelë 3. Tregues të rentabilitetit, ecuria në vite (në përqindje).

	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
ROA <sup>15</sup>	2.1	1.5	1.2	1.24
ROE <sup>16</sup>	20.6	21.6	19.2	19.5

Aktivitet e sistemit bankar kanë qenë në rritje gjatë viteve të fundit. Megjithatë raporti i aktiveve ndaj PBB-së ka pësuar një rënie të lehtë duke manifestuar kryesisht aktivitetin e reduktuar të Bankës së Kursimeve në prag të privatizimit të saj.

Tabelë 4. Totali i aktiveve, ecuria në vite (në miliardë lekë).

	Dhjetor '00	Dhjetor '01	Dhjetor '02	Dhjetor '03
Totali i aktiveve	270.8	318.5	339.3	373.6
Në % ndaj PBB	50.2	53.5	51.6	50.2

Aktiviteti kreditues i bankave të sistemit u rrit me 30.5 për qind gjatë vitit 2003. Megjithëse ky aktivitet përbën vetëm 13.5 për qind të totalit të aktiveve të sistemit, raporti rritet në 27.9 për qind nëse përjashtojmë nga llogaritjet Bankën e Kursimeve<sup>17</sup>. Ky fakt, është një mbështetje e mirë për zgjerimin e mëtejshëm të kreditimit, duke marrë parasysh edhe aktivizimin e Bankës së Kursimeve në fushën e kredidhënies, pas përfundimit të privatizimit të saj.

Treguesi i cilësisë së kreditimit (raporti i kredive me probleme ndaj tepricës së kredisë) llogaritet 4.6 për qind në fund të vitit 2003, nga 5.6 për qind një vit më parë. Përmirësimi i këtij raporti tregon për një punë

<sup>15</sup> Kthyeshmëria nga aktivet. Në vija të përgjithshme mund të thuhet se mat efektivitetin e përdorimit të fondeve të sistemit bankar.

<sup>16</sup> Kthyeshmëria nga fondet e veta.

<sup>17</sup> Me vendim të Bankës së Shqipërisë, Bankës së Kursimeve i është hequr e drejta për të dhënë kredi, për arsye kujdesi.

më të kujdesshme të bankave në akordimin e kredive dhe për uljen e rrezikut në ekonominë shqiptare.

Tabelë 5. Tregues të portofolit të kredive (në përqindje ndaj kredive të klasifikuara).

Treguesi	2000 <sup>18</sup>	2001	2002	2003
1. Kredi të klasifikuara <sup>19</sup>	100.0	100.0	100.0	100.0
- Standarde	59.1	88.3	89.8	92.3
- në ndjekje	7.4	4.6	4.7	3.1
- nënstandarde	3.3	4.0	3.0	1.9
- të dyshimta	4.1	1.7	0.7	0.5
- të humbura	26.0	1.3	1.9	2.1
2. Mbulimi me provigjone	29.7	3.1	2.9	2.9

<sup>18</sup> Vitet 1999 dhe 2000 përfshijnë kreditë me probleme të Bankës së Kursimeve, të cilat kaluan pranë Agjensisë së Trajtimit të Kredive në fundvitin 2001.

<sup>19</sup> Kreditë standarde dhe ato në ndjekje klasifikohen si kredi të rregullta, ndërkohë që tre grupet e tjera të kredive trajtohen si kredi me probleme.

## **ANEKS. LISTA E SUBJEKTEVE FINANCIARE NË SHQIPËRI**

### **SUBJEKTE TË LICENCUARA NGA BANKA E SHQIPËRISË**

#### **BANKA DHE DEGË TË BANKAVE TË HUAJA:**

1. BANKA ITALO - SHQIPTARE
2. BANKA E KURSIMEVE
3. BANKA ARABO-SHQIPTARE ISLAMIKE
4. BANKA DARDANIA
5. BANKA KOMBËTARE TREGTARE
6. BANKA TIRANA
7. DEGA E BANKËS KOMBËTARE GREKE TIRANË
8. BANKA NDËRKOMBËTARE TREGTARE
9. DEGA NË TIRANË E BANKËS ALPHA
10. BANKA AMERIKANE E SHQIPËRISË
11. BANKA PROCREDIT SH.A.
12. DEGA NË TIRANË E BANKËS SË PARË TË INVESTIMEVE SH.A.
13. BANKA TREGTARE E GREQISË (SHQIPËRI) SH.A.
14. BANKA E KREDITIT TË SHQIPËRISË Sh.A.
15. Banka CREDINS. SH.A, TIRANË
16. BANKA POPULLORE

#### **SUBJEKTE JOBANKA**

1. Unioni Financiar i Tiranës Sh.p.k. (UFT)
2. Diners Club Albania Sh.p.k.
3. Posta Shqiptare Sh.a.
4. CREDINS. Sh.a. Tiranë.
5. Fondi i Financimit të Zonave Malore.
6. ALBAKREDIT Sh.p.k.

#### **SUBJEKTE FINANCIARE QË NUK LICENCOHEN NGA BANKA E SHQIPËRISË<sup>20</sup>**

##### **FONDACIONE**

1. Fondi i Financimit Rural.
2. Fondacioni Besa.
3. Partneri Shqiptar për Mikrokreditinë.

##### **ZYRA TË KËMBIMEVE VALUTORE**

Aktualisht, në territorin e Republikës së Shqipërisë, ushtrojnë aktivitet 54 zyra këmbimi.

##### **UNIONET E SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT**

1. Unioni i shoqërive të kursim-kreditit .JEHONA, Tiranë.
2. Unioni i shoqërive të kursim-kreditit UNIONI SHQIPTAR I KURSIMKREDITIT, Tiranë.

---

<sup>20</sup> Këto subjekte, në mbështetje të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 26, datë 29.03.2000 "Për përjashtimin e disa subjekteve nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 8365, datë 02.07.1998 .Për bankat në Republikën e Shqipërisë", nuk licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë. Por, ato kanë detyrimin të raportojnë në Bankën e Shqipërisë.